

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Have Haliti, kryetare, Tonka Berishaj dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Përparim Zeka, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve: SH.D. për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me 31 të KPK-së, S.V. për shkak të gjashtë veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, N.R. për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, A.R. për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, M.B. për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, I.GJ. për shkak të pesë veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, I.A. për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, A.E. për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, B.Z.1. për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, B.Z.2. për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, Q.B. për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, A.G. për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, A.RR. për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga nenin 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, S.N. për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga nenin 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, SH.G. për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga nenin 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, SH.Z. për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, A.K. për shkak të veprës penal të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga nenin 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, L.G. për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, SH.Z. për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me neni 31 të KPK-së, dhe N.Z. për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve: SH.D., av. N.S., N.R., av. A.S., A.R., av. F.G.B., I.GJ., av. ZH.J., I.A., av. F.B., A.E., B.Z.1., av. B.K., A.RR., av. F.L., SH.Z., av. A.B., SH.G., av. B.E., S.N., av. A.H., A.K., av. E.K., A.G., av. M.S., , B.Z.2., av. S.B., L.G., av. A.H., N.Z., av. B.N. dhe ankesat e të akuzuarve Q.B. dhe

SH.Z. si dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit SH.G., av. B.E., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, PKR.nr.22/17 të dt. 04.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.01.2019 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e pjeshëm të ankesave të mbrojtësve të akuzuarve SH.D., S.V., N.R., M.B., I.GJ., I.A., A.E., B.Z.1., B.Z.2., Q.B., A.G., S.N., SH.G., L.G., SH.Z. dhe sipas detyrës zyrtare ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.22/17 të dt. 04.01.2018, përkitazi me cilësimin juridik të veprave penale dhe vendimin për dënim ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit: SH.D., S.V., N.R., M.B., I.GJ., I.A., A.E., B.Z.1., B.Z.2., Q.B., A.G., S.N., SH.G., L.G., SH.Z. i shpall fajtor, secilin veç e veç, për verën penale në vazhdim-marrje rryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 81 par.1.2, 1.3.1.4 dhe 1.5 të KPRK dhe i gjykon: SH.D. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 1500 euro, S.V. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 27 (njëzetë e shtatë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë prej 3000 euro, N.R. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, dhe e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë prej 1000 euro, M.B. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, ndërsa e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 1500 euro, I.GJ. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 22 (njëzetë e dy) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë prej 2500 euro, I.A. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 1000 euro, A.E. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 1000 euro, B.Z.1. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 1500 euro, B.Z.2. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë prej 1000 euro, Q.B. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë prej 1000 euro, A.G. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë prej 1000 euro, S.N. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë prej 1000 euro, SH.G. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 1500 euro, L.G. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 1500 euro, dhe SH.Z. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, kurse e merr si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 1500 euro. Të akuzuarve në dënimin e shqiptuar me burgim do të iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.19.12.2016 deri me dt. 30.03.2017, ndërsa të akuzuarit

B.Z.1., do ti llogaritet koha e kaluar në ndalim policor dhe në arrest shtëpiak nga dt.19.12.2016 deri me dt. 31.12.2016.

Në pjesën tjetër aktgjykimi i përmendur përkitazi me këta të akuzuar mbetet i pa ndryshuar.

II. Refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve A.R., A.RR., A.K.t dhe N.Z. si dhe ankesa e të akuzuarit SH.Z., kurse aktgjykimi i përmendur përkitazi me këta të akuzuar vërtetohet.

III. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore-DKR në Prizren, me aktgjykimin PKR.nr.22/17 të dt.04.01.2018, të akuzuarin SH.D., e ka shpallur fajtor për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së (dispozitivi nën pikën I, II dhe XXI), dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro dhe dënim me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par.1 e 2, nën par 2.4 dhe 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1500 euro, dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 muaj. Të akuzuarin S.V., e ka shpallur fajtor për shkak të gjashtë veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së (dispozitivi nën pikën I, II, IX, XII, XVI dhe XXI) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë nga 500 euro si dhe dënim me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par.1 e 2, nën par 2.4 dhe 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 3000 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 31 muaj. Të akuzuarin N.R., e ka shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika III dhe XXII, të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënim me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par.1 e 2, nën par. 2.4 dhe 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 muaj. Të akuzuarin A.R., e ka shpallur fajtor për veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika III të dispozitivit), i ka shqiptuar dënim e gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj. Të akuzuarin M.B., e ka shpallur fajtor për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika VI, XI dhe XV të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënim me burgim me nga 5 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par.1 e 2, nën par 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1500 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 12 muaj. Të akuzuarin I.GJ., e ka shpallur fajtor për shkak të pesë veprave penale të marrjes së ryshfetit nga

neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika IV, VI, XI, XV dhe XIX, të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënim me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par.1 e 2, nën par. 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 2500 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 25 muajve. Të akuzuarin I.A., e ka shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika VII dhe X të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro, si dhe dënim me burgim me nga 6 muaj ashtu që në kuptim të nenit 80 par.1 e 2, nën par 2.4 e 2.5 KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajve. Të akuzuarin A.E., e ka shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së (pika VII, dhe X të dispozitivit ) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë nga 500 euro si dhe dënim me burgim prej 5 muajve, ashtu që në kuptim të nenit 80 par.1 e 2, nën par. 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve. Të akuzuarin B.Z.1., e ka shpallur fajtor për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika VII, IX, dhe XVIII, të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënim me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par 1 e 2, nën par. 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i është shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1500 euro e dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 muajve. Të akuzuarin B.Z.2., e ka shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika IV dhe VIII të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç, i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënimi me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par 1 e 2, e nën par. 2.4 dhe 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1000 euro e dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajve. Të akuzuarin Q.B., e ka shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe atë ( pika VIII dhe XIII të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç, i është shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënimi me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par 1 e 2, nën par. 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajve. Të akuzuarin A.G., e ka shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika IX dhe XII të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i është shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënimi me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par 1 e 2, nën par 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajve. Të akuzuarin A.RR., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së (pika XIII të dispozitivit) dhe i ka është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj. Të akuzuarin S.N., e ka shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale të marrjes së ryshfetit nga

neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së (pika XII dhe XVI të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënim me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par 1 e 2, nën par. 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i është shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajve. Të akuzuarin SH.G., e ka shpallur fajtor për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së ( pika IV, XI dhe XIX të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i është shqiptuar dënimi me gjobë me nga 500 euro si dhe dënimi me burgimi me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par. 1 e 2, nën par. 2.4 dhe 2.5 të KPRK të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 1500 euro dhe dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 muajve. Të akuzuarin SH.Z., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe ( pika XX të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj. Të akuzuarin A.K., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-(pika XX të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj. Të akuzuarin L.G., e ka shpallur fajtor për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së (pika V, XIV dhe XVII të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i është shqiptuar dënimi me gjobë me nga 500 euro si dhe dënimi me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par 1 e 2, nën par. 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej 1500 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 muajve. Të akuzuarin SH.Z., e ka shpallur fajtor për shkak të tri veprave penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, (pika V, XIV, dhe XVII të dispozitivit) dhe për secilën vepër veç e veç i ka shqiptuar dënim me gjobë me nga 500 euro si dhe dënim me burgim me nga 6 muaj, ashtu që në kuptim të nenit 80 par 1 e 2, nën par. 2.4 e 2.5 të KPRK të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1500 euro dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 muajve. Të akuzuarin N.Z., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, (pika XXII, të dispozitivit) dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1000 euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve.

Të akuzuarit janë obliguar që në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ti paguajnë dënimet e shqiptuara me gjobë. Në rast se të akuzuarit nuk i paguajnë dënimet me gjobë apo nuk mundën ti paguajnë, dënimet me gjobë do të iu zëvendësohen me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do t'iu caktohet një ditë burgim.

Të akuzuarve në dënimin e shqiptuar me burg, do të iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.19.12.2016 deri me dt. 30.03.2017, ndërsa të akuzuarit B.Z.1., do ti llogaritet koha e kalimit në ndalim policor dhe në arrest shtëpiak nga dt.19.12.2016 deri me dt. 31.12.2016.

Janë obliguar të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor me nga 200 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore, dhe të akuzuarve t'u shqiptojë dënim më të rëndë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit SH.D., av. N.S., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta merr ankesën si të themeltë dhe të bazuar në ligj, dhe aktgjykimin ta ndryshojë apo ta anulojë dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

-Mbrojtësi i të akuzuarit N.R., av. A.S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta anulojë aktgjykimin e atakuar apo ta ndryshojë në dobi të akuzuarit N.R..

-Mbrojtësja e të akuzuarit A.R., av. F.G.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal të Kosovës, vërtetimi jo i drejtë dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin e shqiptuar, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të nxirret aktgjykim lirues.

-Mbrojtësi i të akuzuarit I.GJ., av. ZH.J., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë apo ta anulojë dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe vendosje.

-Mbrojtësja e të akuzuarit I.A., av. F.B., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe që aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta anulojë, dhe lëndën ta kthej në rigjykim apo të akuzuarin ta liroj nga aktakuza.

-I akuzuari A.E., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesën ta aprovoj si të bazuar, dhe gjykata ti shqiptojë një dënim më të ulët.

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.Z.1., av. B.K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore ashtu që të akuzuarin B.Z.1. ta liroj nga akuza.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.RR., av. F.L., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të liroj të akuzuarin A.RR. nga akuza, ose të anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë gjykatës së shkallës së parë çështjen në rigjykim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit SH.Z., av. A.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së Kodit Penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe të marrë aktgjykim lirues ose ta anulojë aktgjykimin dhe lëndën ta kthej në rivendosi apo ta ndryshojë përkritazi me vendimin mbi dënimin, duke i shqiptuar të akuzuarit një dënim sa më të butë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit SH.G., av. B.E., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të akuzuarin SH.G. ta lirojë nga akuza.

-Mbrojtësi i të akuzuarit S.N., av. A.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimi mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë në tërësi ankesën e mbrojtësit si të bazuar, ashtu që aktgjykimin ta ndryshojë dhe të mbrojturin e tij ta lirojë nga akuza, ose ta anulojë dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.K., av. E.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza, ose ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe çështjen t'ia kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, apo ta ndryshojë dënimin me gjobë dhe me burgim, ashtu që ti shqiptojë një dënim me gjobë më të butë, dhe dënimin me burgim t'ia zëvendësojë me dënim me gjobë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.G., av. M.S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që të akuzuarin ta lirojë nga aktakuza, ose aktgjykimin ta anulojë, dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

-I akuzuari SH.Z., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimi mbi dënimin, me propozim që ta aprovojë si të bazuar ankesën dhe të akuzuarin ta lirojë nga aktakuza, ose ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe çështjen ta kthej në rigjykim gjykatës së shkallës

së parë, apo ta ndryshojë dënimin me gjobë dhe me burgim, ashtu që ti shqiptojë një dënim me gjobë më të butë, dhe dënimin me burgim t'ia zëvendësojë me dënim me gjobë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.Z.2., av. S.B., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje.

-Mbrojtësi i të akuzuarit L.G., av. A.H., për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta anulojë aktgjykimin dhe çështjen penale t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe vendim ose ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar.

-I akuzuari Q.B., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të akuzuarit, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe lënda të kthehet në rivendosje ose të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të shqiptohet një dënim më i butë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit N.Z., av. B.N., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në prizren ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit SH.G., av. B.E. me propozim që të refuzohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren si e pabazuar kurse ankesën e mbrojtësit të akuzuarit SH.G. të paraqitur kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë ta aprovohet si të bazuar.

Prokurori i Apelit në parashtrësën PPA/I.nr.232/18 të dt. 24.05.2018 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarve tu shqiptohen dënime sa më të larta, kurse ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, Gjykata e Apelit ka mbajtur seancën e kolegjit në të cilën ishin të pranishëm i akuzuari SH.D. dhe mbrojtësi i tij av. N.S., i akuzuari S.V. dhe mbrojtësi i tij av.H.M., i akuzuari N.R. dhe mbrojtësi i tij av.A.S., i akuzuari A.R., mbrojtësja e tij av.F.G.B., mungoi, është ftuar në mënyrë të rregullt, i akuzuari I.GJ. dhe mbrojtësi i tij av.ZH.J., i akuzuari I.A., mbrojtësja e tij av.F.B., mungoi edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt, i akuzuari A.E., i akuzuari B.Z.2. dhe mbrojtësi i tij av. S.B., i akuzuari Q.B., i akuzuari A.G. dhe mbrojtësi i tij av.M.S., i akuzuari A.RR. dhe mbrojtësi i tij av.F.L., i akuzuari S.N. dhe mbrojtësi i tij av.A.H., i akuzuari SH.G. dhe mbrojtësi i tij avokati me autorizim zëvendësues A.T., i akuzuari L.G., mbrojtësi i tij av.A.H., mungoi, është ftuar në mënyrë të rregullt, i akuzuari SH.Z. dhe mbrojtësi i tij av.A.B., i akuzuari N.Z. dhe mbrojtësi i tij av.B.N., i akuzuari B.Z.1. dhe mbrojtësi i tij



avokatja me autorizim zëvendësues B.G.. Prokurori i Apelit dhe i akuzuari M.B. munguan edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt. Seanca e kolegjit është mbajtur konform nenit 390 par. 4 të KPPK, në mungesë të palve të ftuara në mënyrë të rregullt. Mbrojtësit e të akuzuarve bënë disa sqarime dhe mbetën pran pretendimeve në ankesat e tyre, ndërsa të akuzuarit i mbështetën plotësisht mbrojtësit e tyre dhe ankesat.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore të Republikës së Kosovës, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve si dhe ankesat e të akuzuarve së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat janë pjesërisht të bazuara

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Mbrojtësit e të akuzuarve dhe të akuzuarit SH.Z. dhe Q.B., aktgjykimin e gjykatës së shkallë së parë e ankimojnë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale duke pretenduar se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale nga neni 384 par.1, nënpar.1.12 dhe par.2, nënpar.2.1 të KPPK-së. Në ankesat e mbrojtësve theksohet se aktgjykimi nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare për vendosjen e çështjes, kurse arsyet e paraqitura janë në kundërshtim me përmbajtjen e dëshmive dhe të shkresave të lëndës dhe në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë nuk i ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i ka konsideruar si të vërtetuara, në raport me të akuzuarit si dhe cilat janë ato veprime të cilat do të përmbushnin figurën e veprës penale të marrjes së rryshfetit si dhe nuk arsyetohet asnjë rrethanë se kush ishte dhënësi apo a ka palë të dëmtuar në këtë çështje penale. Shkelja tjetër sipas mbrojtësve të akuzuarve konsiston edhe në shkeljen e nenit 384 par.1, nënpar.1.8 sepse aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme, nga fakti se i gjithë aktgjykimi është bazuar në provën e vetme siç është CD-ja e video incizimit. Kjo provë sipas mbrojtësve nuk është marrë në mënyrë të ligjshme për arsye se urdhëresa për aplikimin e masës së fshehtë nuk është marrë në pajtim me dispozitën e nenit 92 par.1 nën par 1.3 të KPPK-së, pasi që ligjdhënësi ka paraparë që me rastin e lëshimit të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit të shënohet emri dhe adresa e personit apo personave që i nënshtrohen urdhrin si dhe baza ligjore e saktë e saj, e në rastin konkret urdhëresa e lëshuar nuk përmban as emrin e as adresën e po ashtu as të dhëna të tjera të parapara me nenin 92 të KPPK-së, e nga këto përgjime vërehet edhe komunikimi me anëtarët e familjes, ku janë shkelur edhe të drejtat e garantuara me Konventat Ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pretendojnë se përshkrimi i veprës nuk është i drejtë sepse në të nuk janë dhënë faktet dhe elementet që e përbëjnë figurën e kësaj vepre penale, dhe në veçanti nuk janë përshkruar veprimet e të akuzuarit SH.Z., nuk është konstatuar se cili ishte aktiviteti i përbashkët funksional, kontributi thelbësor apo kauzal si dhe ekzistimi i marrëveshjes paraprake.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore, por edhe sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 par. 1 të KPPK-së, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara e as shkelje për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Pra, dispozitivi i aktgjykimit, si dhe aktgjykimi i ankimuar në tërësi është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare, të kësaj çështje juridiko-penale. Kështu, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është i plotë dhe i kuptueshëm, me asgjë të njëjtin nuk e bënë dubioz. Është bërë përshkrimi i duhur i veprimeve inkriminuese të secilit të akuzuar veç e veç, por janë dhënë edhe tiparet dhe faktet vendimtare për secilin prej tyre. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin dhe analizën e provave të administruara, gjatë shqyrtimit gjyqësor në pajtim me dispozitën e nenit 361 të KPPK(Kodi i vjetër neni 387) dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta. Pra, për qëndrimin e vlerësimit të saj, përkitazi me provat e administruara janë dhënë arsye të hollësishme. Edhe mbrojtjet e të akuzuarve kanë qenë objekt i vlerësimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ato janë vlerësuar si çdo provë tjetër, në pajtim me nenin 361 të KPPK.

Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, konkludimet të cilat i ka nxjerrë gjykata e shkallës së parë janë të drejta sepse kanë mbështetje në provat e administruara dhe jo vetëm që janë drejtë të vërtetuara, por edhe në mënyrë të plotë dhe të qartë janë të arsyetuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar mbështetet në prova të papranueshme, konkretisht CD e video dhe audio incizimit të siguruara nga masat e fshehta dhe transkriptet e bisedave të nxjerra nga këto CD nga Inspektorati Policor. Në fakt, nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar del se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e mbështetet përveç tjerash edhe në CD e video dhe audio incizimit të siguruar nga masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit të cilat janë zbatuar në mënyrë të ligjshme sipas urdhëresës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren me nr. 156/2016 të dt. 25.11.2016 në kuptim të nenit 91 par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.11 të KPPK. Gjykata e shkallës së parë urdhrin e përmendur e ka lëshuar pas kërkesës të Prokurorit SEK 165/16 të dt. 25.11.2016. Është fakt se urdhri i përmendur nuk përmban shënimet personale të personave ndaj të cilëve duhet të zbatohet, por në të njëjtin konstatohet: "Për të dyshuarit zyrtar policor, nga Njësia e Kontrollit të Autostradave të cilët drejtojnë automjetet: Shkoda Rapid, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit POLICE-XXX-01 dhe XXX-01". Mirëpo, dispozita e nenit 84 par. 2 të KPPK: "Për autorizimin e masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit nga paragrafi 1, prokurori i shtetit ose gjyqtari i procedurës paraprake nuk është e domosdoshme të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të

dysshuarit apo të dysshuarve të cilët kanë kryer, janë duke kryer ose së shpejti do të kryejnë veprë penale”.

Nga shkresat e lëndës rezulton se masat e përmendura janë urdhëruar para fillimit të procedurës penale ndaj të akuzuarve. Në fakt, aktvendimi për fillimin e hetimeve është lëshuar me dt. 20.12.2016 ( aktvendimi PP nr. 314/2016), prandaj sipas dispozitës së nenit 84 par. 2 të KPPK nuk është e domosdoshme që urdhri të përmbajnë shënimet për identitetin e të dysshuarit apo të dysshuarve.

Nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë fare nuk e ka vlerësuar transkriptën e masave të fshehta të IPK-së Departamenti për hetime speciale, si konstaton edhe në faqen 49, pasusi i pestë të aktgjykimit, me arsyetim se janë dyfishim i video incizimeve, që do të thotë se këto transkripte nuk janë prova relevante në cilat mbështeten konkludimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të akuzuarve, prandaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk është e nevojshme të jepet ndonjë arsye lidhur me provueshmërinë e tyre si prova në këtë çështje.

Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi ankimor i mbrojtësit të të akuzuarit N.R. se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm duke pasur parasysh faktin se “në faqen 12 të aktgjykimit thotë dënohet me burg prej 6 muaj veç e veç, ndërsa në faqen tjetër 13 i shqipton dënim me burg unik në kohëzgjatje prej 10 muaj,?!”. Në fakt, nga shikimi i aktgjykimit del se i akuzuari N.R. është shpallë fajtor për dy vepra penale (dispozitivi nën pikën III dhe XXII) dhe gjykata për secilën veprë penale veç e veç i ka përcaktuar dënim me gjobë me nga 500 € dhe dënim me burgim me nga 6 muaj ( pika 3 e pjesës gjyquese të aktgjykimit, faqja 12, pasusi i fundit) dhe pastaj me aplikimin e nenit 80 par. 1 dhe 2 nën par. 2.4 dhe 2.5 të KPRK, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1000 € dhe dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajve ( e njëjta pikë, faqja 13). Pra, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar dispozitën e nenit 80 të KPRK për dënim për bashkim të veprave penale, ndërsa për shkelje të ligjit penal për cilësimin juridik të veprave penale do të bëhet fjalë në pjesën e aktgjykimit lidhur me bazën ankimore-shkelja e ligjit penal.

Përveç kësaj, mbrojtësi i të akuzuarit N.R. pretendon se gjykata e shkallës së parë ka tejkalluar aktakuzën sa i përket shumës së parave që pretendohet se i ka marrë ky i akuzuar nga kundërvajtësit, objekt i dispozitivit të në pikën III të aktgjykimit në cilin shënohet shuma prej 1000 € që është në është në kundërshtim me dispozitivin e aktakuzës në cilin konstatohet shuma prej 100 €. Qëndron fakti se në përshkrimin faktik në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit në rreshtin e gjashtë (të përshkrimit faktik në fjalë) shkruan me shkronja “njëqind”, ndërsa me numra në kllapa “(1000)”, mirëpo sipas vlerësimit të kësaj Gjykate kemi të bëjmë me gabim teknik e jo me tejkallim aktakuze sepse me shkronja precizohet shuma ekuivalente me shumën e cekur në dispozitiv të aktakuzës, prandaj ky gabim teknik nuk mund të vlersohet si tejkallim i aktakuzës, siç pretendon pa të drejtë mbrojtësi në ankesën e tij.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, të pabazuara janë edhe pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shpallë fajtor duke u mbështetur vetëm në një provë në kundërshtim me dispozitën e nenit 262 të KPPK. Nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e mbështetë në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, konkretisht CD-të që përmbajnë video dhe audio incizimet të siguruar nga zbatimi i masave të fshehta të urdhëruara në pajtim me dispozitat e KPPK nga Gjykata kompetente, por edhe në oraret ditore-fletat patrulluese dhe pjesërisht në mbrojtjen e të akuzuarve.

Sipas dispozitës së nenit 262 par. 1 të KPPK :’’ Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtja përmes marrjes në pyetje në ndonjë fazë të procedurës penale’’.

Në rastin konkret, ashtu si u tha edhe më lartë, gjykata e shkallës së parë nuk i ka shpallur fajtor të akuzuarit vetëm duke u mbështetur në një prove sepse përveç CD-eve të përmendura gjykata gjendjen faktike e mbështetë edhe në orarin e punës-fletët patrulluese, por edhe mbrojtja e të akuzuarve (përveç atyre që u mbrojtjen në heshtje) që ishin vlerësuar si çdo provë tjetër në pajtim me nenin 361 par. 2 të KPPK. Nga shikimi i procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor rezulton se të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre kishin mundësi që ti kundërshtojnë provat në fjalë, ndërsa gjykata u ka dhënë përgjigje secilit veç e veç lidhur me kundërshtimet e tyre.

Sa u përket pretendimeve ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve se organet e ndjekjes kanë bërë seleksionimin e personave duke ndërhyrë në incizimet ashtu që një numër i personave është hequr nga këto incizime dhe ndaj tyre nuk është filluar fare procedura penale, kjo Gjykatë vënë në dukje faktin se gjykata është e lidhur me identitetin subjektiv dhe objektiv të akuzës, pra aktgjykimi mund t’i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës penale që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor. Prandaj, pretendimet e ngritura nga mbrojtësit të të akuzuarve nuk janë e as që mundën të jenë objekt i shqyrtimit të kësaj Gjykate.

Përkritazi me pretendimin ankimor se nga përshkrimi faktik e as nga përmbajtja e arsytimit të aktgjykimit nuk dihet identiteti i të dëmtuarve, pikërisht kush janë dhënësit e ryshfetit e as shuma e saktë të cilën pretendohet se e kanë pranuar të akuzuarit edhe kjo Gjykatë vlerëson se do të ishte mirë që të dihet se kush është dhënësi i ryshfetit dhe shuma e saktë, mirëpo duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, sidomos faktin se objekt i kontrollit nga patrullat policore ( tani të akuzuar) ishte një numër i madh i vozitësve të veturave që kalonin në autostradë dhe përmbajtjen e incizimeve nga CD e përmendura, të administruara si prova, edhe në mungesë të identitetit të dhënësit të ryshfetit padyshim vërtetohen veprimet e secilit të akuzuar veç e veç, qoftë si kryerës aktiv apo pasiv ( policët që kanë komunikuar me kundërvajtësit apo ata që kanë vëzhguar duke matur shpejtësinë apo plotësuar tiketat), veprime këto që në rastin konkret edhe i bëjnë bashkëkryerës sepse tek ata ka ekzistuar dashja dhe veprimi i përbashkët për t’i ndërmarrë veprimet inkriminuese.

Nga arsyet e theksuara si më lartë, pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale u refuzuan si të pabazuara.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike,

Për sa i takon bazës ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve SH.D., N.R., A.R., I.GJ., I.A., B.Z.1., A.RR., SH.Z., SH.G., S.N., A.K., A.G., B.Z.2., L.G., N.Z. dhe ankesat e të akuzuarve SH.Z. dhe Q.B., në esencë kontestojnë mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet që i ka nxjerrë ajo në bazë të provave që i kishte proceduar.

Në fakt, në ankesat theksohet se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sepse i tërë aktgjykimi është bazuar në një provë të vetme, siç është CD-ja për të cilën pretendojnë se është provë e papranueshme e siguruar me anë të masave të hetimit dhe vëzhgimit të fshehtë, duke mos pasur prova të tjera mbështetëse të cilat do të kishin vërtetuar elementet inkriminuese të akuzuarve. Në ankesa theksohet se gjykata nuk ka arritur të arsyetoj bindshëm aktgjykimin me të cilin janë shpallur fajtor të akuzuarit për vepër penale të marrjes së ryshfetit, se sa ka qenë vlera që të akuzuarit e kanë pranuar nga kundërvajtësit, në sa ora i kanë pranuar ato, me cilën datë, në cilin vend, mënyrën e pranimit, identifikimin e kundërvajtësve, dëgjimin e dëshmitarëve që në rastin konkret nuk ka pasur asnjë dëshmitar sepse sipas tyre, konsiderojnë se për vërtetim të plotë të gjendjes faktike është dashur të dëgjohen ndonjëri nga kundërvajtësit në cilësi të dëmtuarve, por këta kundërvajtës kanë mbetur të panjohur, të pa identifikuar, andaj, në rastin konkret një person nuk mund të shpallet fajtor për marrje të ryshfetit pa u ditur identiteti i dhënësit të ryshfetit kur dihet se edhe dhënia e ryshfetit është vepër penale e dënueshme. Në ankesa tutje vazhdohet me pretendimet se nga transkriptet e siguruar të cilat janë dëgjuar, në to askund nuk flitet se të akuzuarit kanë përmendur para dhe se përpilimi i tërë ngjarjeve bazohet në biseda ku thuhet se nuk dëgjohet se çka po flitet dhe se nuk shihet se çka kanë në dorë të akuzuarit, duke supozuar se ato janë kartëmonedha dhe si të tilla këto janë prova të pa pranueshme deri sa nuk janë të konfirmuara, ngase këto mund të kenë qenë edhe dokumente të veturave të cilat të akuzuarit i kanë ndalur.

Përveç këtyre mbrojtësi i të akuzuarit SH.G., av. B.E. në ankesë veçon se në lidhje me të mbrojturin e tij, gjykata ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se të gjitha provat e shqyrtuara në shqyrtimin gjyqësor janë shqyrtuar për datën 08.12.2016, ku është vërtetuar se i mbrojturi i tij nuk ka qenë fare në punë, ndërsa prokuroria nuk tërhiqet nga kjo pikë e dispozitivit të aktakuzës, mirëpo vetëm përmirëson dhe thekson se është bërë një gabim teknik, ku në vend të datës 08.12.2016 është dashur të jetë 02.12.2016.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Faktet vendimtare që i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë me asgjë nuk vihen në dyshim. Në rastin

konkret, as me ankesa nuk vihet në dyshim konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ofrohet asnjë provë, asnjë fakt që do të shpinte në vërtetimin e faktit se të akuzuarit nuk janë kryes të veprës penale që ju vihet në barrë. Ligjshmëria e provave të siguruara nga zbatimi i masave të fshehta është trajtuar në pjesën e aktgjykimit që i referohet bazës ankimore nga neni 384 të KPPK (shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale) dhe kjo Gjykatë nuk e sheh të nevojshme që ta përsërisë edhe një herë.

Pra, nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e mbështetë në CD video dhe audio incizimeve nga vendi i ngjarjes të siguruara nga zbatimi i masave të fshehta të urdhëruara nga gjykata dhe në orarin ditor dhe raportin e punës për secilin të akuzuar veç e veç. Nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar del se gjykata e shkallës së parë qartë dhe në mënyrë detaje ka paraqitur përmbajtjen e këtyre provave (CD video dhe audio incizimet por edhe orarin e punës) për secilin të akuzuar (faqja 35-49 të aktgjykimit të ankimuar) duke iu referuar datës kur janë incizua pamjet që përmban CD (30.11.2016, 03.12.2016, 01.12.2016, 02.12.2016, 04.12.2016, 05.12.2016, 06.12.2016, 08.12.2016, 09.12.2016, 10.12.2016, 11.12.2016, 12.12.2016 dhe 13.12.2016) si dhe kohës dhe veprimit konkret të akuzuarve dhe kjo Gjykatë nuk e sheh të arsyeshme që ti përsërisë edhe një herë vetëm për tu përgjigjur pretendimeve ankimore. Në fakt, kjo Gjykatë ka bërë shikimin e incizimeve që përmban secila CD sipas datave të përmendura dhe pas krahasimit të tyre me faktet të paraqitura në aktgjykimin e ankimuar gjeti se ato korrespondojnë plotësisht njëra me tjetrën.

Po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit janë paraqitur qartë dhe detaisht faktet që vërtetohen nga orari i punës të të akuzuarve në kohën kontestuese, pikërisht veturat që i kishin në dispozicion të akuzuarit, por edhe përbërja e ekipit (patrullës), fakte këto që nuk u kontestuan me ndonjë provë konkrete, përveç në rastin e të akuzuarit B.Z.2. i cili ka dëshmuar se me dt. 08.12.2016, ishte në pushim vjetor dhe mbi bazën e provave të proceduara për këtë rrethanë Prokurori i Shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka bërë përmirësimin e kohës së kryerjes së veprës penale duke precizuar saktë datën që korrespondon me provat e përmendura e që është 02.12.2016.

Kështu, nga orari ditor i punës i Drejtorisë Rajonale të Policisë dhe Raporti i patrullës së Njësisë Rajonale të trafikut vërtetohet si në vijim: për datën 30.11.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e pasdites prej orës 15:00 deri në ora 23:00 kanë qenë të akuzuarit S.V. dhe SH.D.; për datën 01.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit A.R. dhe N.R.; për datën 08.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit M.B., SH.G. dhe I.GJ.; për datën 02.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e pasdites prej orës 15:00 deri në ora 23:00 kanë qenë të akuzuarit SH.G., B.Z.2. dhe I.GJ.; për datën 02.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e natës prej orës 23:00 deri në ora 07:00 kanë qenë të akuzuarit SH.D. dhe S.V.; për datën 04.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e pasdites prej orës 15:00 deri në ora 23:00 kanë

qenë të akuzuarit SH.Z. dhe L.G.; për datën 03.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e natës nga ora 23:00 deri në ora 07:00 kanë qenë të akuzuarit M.B. dhe I.GJ.; për datën 04.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police 470-01 në ndërrimin e natës prej pres 23:00 deri në ora 07:00 kanë qenë të akuzuarit B.Z.2. dhe Q.B.; për datën 04.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit A.E., B.Z.1. dhe I.A.; për datën 05.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit A.G. dhe S.V.; për datën 06.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e pasdites prej orës 15:00 deri në ora 23:00 kanë qenë të akuzuarit A.E., B.Z.1. dhe I.A.; për datën 08.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e pasdites kanë qenë të akuzuarit A.G., S.V. dhe S.N.; për datën 09.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e pasdites prej orës 15:00 deri në ora 23:00 kanë qenë të akuzuarit A.RR. dhe Q.B.; për datën 09.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit SH.Z. dhe L.G.; për datën 10.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e pasdites prej orës 15:00 deri në ora 23:00 kanë qenë të akuzuarit M.B. dhe I.GJ.; për datën 11.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit A.E. dhe B.Z.1.; për datën 11.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e pasdites prej orës 15:00 deri në ora 23:00 kanë qenë të akuzuarit SH.Z. dhe L.G.; për datën 11.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e natës prej orës 23:00 deri në ora 07:00 kanë qenë të akuzuarit SH.G. dhe I.GJ.; për datën 12.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit SH.Z. dhe A.K.; për datën 13.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit S.V. dhe SH.D.; për datën 10.12.2016, është vërtetuar se në automjetin e policisë me targa Police XXX-01 në ndërrimin e paradites prej orës 07:00 deri në ora 15:00 kanë qenë të akuzuarit N.R. dhe N.Z..

Ndërsa, nga shikimi i CD-ve të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe të administruara si prova në shqyrtimin gjyqësor ( të shikuara edhe nga kolegji i kësaj Gjykate), vërtetohen faktet se të akuzuarit kanë vepruar në mënyrën si është precizuar edhe në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar. Pra, nga këto pamje por edhe nga audio incizimi pa dyshim vërtetohet se në mes të akuzuarve dhe dhënësve të ryshfetit ka pasur një marrëveshje të heshtur për shkëmbim shërbimesh. Në fakt, pasi që të akuzuarit i ndalojnë kundërvajtësit, iu komunikojnë shkeljen dhe dënimin e përcaktuar me ligje për atë kundërvajtje, në disa raste i pranojnë parat në emër të pagesës për kundërvajtje por nuk i plotësojnë tiketat e trafikut, gjegjësisht ju thonë se nëse kërkojnë tiketë me shkrim atëherë duhet me ia ndalë patentë shoferin dhe pagesa duhet të bëhet në Prizren, ose në disa raste për mos plotësimin e tiketave pranojnë të holla si dhuratë nga

kundërvajtësit të cilat ua japin në dorë ose i lënë në veturë dhe të cilat pastaj të akuzuarit i ndajnë në mes veti. Pra nga këto fakte pa dyshim vërtetohet lidhja shkakësore në mes dhuratës së marrë dhe veprimit të paligjshëm, gjegjësisht mosveprimit në pajtim me detyrën e tyre zyrtare.

Për ekzistimin e veprës është e parëndësishme nga kush ka rrjedhë iniciativa për ryshfet-nga dhënësi apo nga marrësi i ryshfetit dhe kjo vepër është e kryer me vetëm kërkimin, gjegjësisht pranimin e ryshfetit ( pa marr parasysh vlerës).

Nga arsyet e cekura si më lartë nuk janë aprovuar pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe se e gjithë ajo që është thënë në aktgjykimin e ankimuar përkitazi me gjendjen faktike në tërësi e mbështetë edhe kjo Gjykatë, që do të thotë se i akcepton të gjitha arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë si për rrethanat e rastit konkret ashtu edhe për rrethanat se pse nuk janë aprovuar tezat e mbrojtësve të akuzuarve dhe vet të akuzuarve.

Shkelja e ligjit penal.

Mbrojtësit e të akuzuarve dhe të akuzuarit në ankesat e tyre pretendojnë se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ka ndikuar që me shpalljen fajtor të akuzuarve për veprat penale marrje e ryshfetit nga neni 428 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, është shkelur ligji penal në dëm të tyre sepse me asnjë provë nuk janë vërtetuar se veprimet e të akuzuarve përbëjnë elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

Përveç këtyre shkeljeve mbrojtësit e të akuzuarve I.GJ. dhe L.G.t dhe i akuzuari A.B. pretendojnë se në raport me këta të akuzuar është shkelur ligji penal edhe për faktin se të akuzuarit janë shpallur fajtor për disa vepra penale edhe pse plotësohen kushtet ligjore për që këto veprime të cilësohen si vepër penale në vazhdim.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore, por edhe duke shqyrtuar aktgjykimin sipas detyrës zyrtare, gjen se gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal në dëm të akuzuarve nga neni 385 par. 1 nën par. 1.4 të KPPK-së, sepse është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet.

Nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar del se disa prej të akuzuarve janë shpallur fajtor për disa vepra të njëjta penale të cilat i kanë kryer në vendin e njëjtë (Autostrada "Ibrahim Rugova") duke shfrytëzuar të njëjtën situatë me kontinuitet kohor në mes veprave, me motiv, gjegjësisht me dashje të njëjtë. Në fakt, sipas aktgjykimit të ankimuar të akuzuarit janë shpallë fajtor për veprat penale të marrjes së ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK si në vijim:

SH.D. është shpallur fajtor për tri vepra ( dispozitivi I,II dhe III), i akuzuari S.V. për 6 vepra penale ( dispozitivi I,II, IX,XII,XVI, dhe XXI), N.R. për dy vepra penale (dispozitivi II dhe



XXII), M.B. për 3 vepra penale (dispozitivi VI,XI dhe XV), I.GJ. për 5 vepra penale (dispozitivi IV,VI,XV dhe XIX), I.A. për 2 vepra penale (dispozitivi VII dhe X), A.E. po ashtu për 2 vepra penale (dispozitivi VII dhe X), B.Z.1. për 3 vepra penale (dispozitivi VII,X dhe XVIII), B.Z.2. për 2 vepra penale (dispozitivi IV dhe VIII), Q.B. për 2 vepra penale (dispozitivi VIII dhe XIII), A.G. për 2 vepra penale (dispozitivi IX dhe XII), S.N. për 2 vepra penale (dispozitivi XII dhe XVI), SH.G. për 3 vepra penale (dispozitivi IV,XI dhe XIX), L.G. për 3 vepra penale (dispozitivi V, XIV dhe XVII) dhe SH.Z. për 3 vepra penale (dispozitivi V, XIV dhe XVII).

Duke pasur parasysh arsyet e theksuara si më lartë, Gjykata e Apelit vlerëson se veprimet e të akuzuarve të përmendur, përbëjnë elementet e veprës penale në vazhdim, sipas kushteve të parashikuar me nenin 81 të KPRK.

Në fakt, dispozita në fjalë (neni 81 par. 1 të KPRK) parashikon se vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: viktimës së njëjtë të veprës penale, objekti i njëjtë, shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore, vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale dhe dashja e njëjtë e kryerësit.

Pra, në rastin konkret plotësohen më shumë se dy kushte të përcaktuara me dispozitën e cituar më lartë, sepse të akuzuarit, ashtu si u tha edhe më lartë, veprimet e tyre i kanë kryer në kontinuitet kohor prej 30.11.2016 deri më 13.12.2016, vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale dhe dashja e njëjtë duke e shfrytëzuar situatën e njëjtë. Prandaj, kjo Gjykatë gjen se veprimet e të akuzuarve SH.D., S.V., N.R., M.B., I.GJ., I.A., A.E., B.Z., B.Z.2., Q.B., A.G., S.N., SH.G., L.G., dhe SH.Z., përbëjnë elementet e veprës penale në vazhdim marrje e rryshfetit në bashkëkryerje nga neni 428 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 81 par. 1 nën par. 1.3, 1.4 dhe 1.5 të KPRK, për cilën vepër penale edhe i shpalli fajtor.

Nga arsyet e theksuara si më lartë aktgjykimi i ankimuar u ndryshua sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimit për dënimin pasi që të akuzuarit u shpallën fajtor dhe u gjykuan për vepër penale në vazhdim.

#### Vendimi mbi dënimin

Sa i përket vendimit mbi dënimin, në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren theksohet, taksativisht: "Konsiderojmë se dënimi i shqiptuar nuk është në proporcion me peshën e veprës penale, nuk e arsyeton qëllimin e dënimit në kuptim të nenit 41 par.1 nën par 1.1. dhe 1.2 të KPK-së, të parandaloj të dënuarit nga kryerja e veprave penale dhe si masë e prevencionit të përgjithshëm të parandaloj kryerjen e veprave penale të tilla. Nga këto arsye aktgjykimi i ankimuar është i pa qëndrueshme me arsyet e shqiptimit të dënimit. Prokuroria Themelore në Prizren Departamenti për krime të rënda, duke mos qenë i kënaqur me aktgjykim dhe dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarve nga shkaqet dhe lëshimet e gjykatës së shkallës së parë që u përmenden më lartë, kërkon nga Kolegji i Gjykatës së Apelit-Departamenti për krime të rënda në

Prishtinë pas shqyrtimit të tërësishëm të shkresave të lëndës dhe ankesës së parashtruar të vendos në mënyrë meritore konform propozimit.”

Ndërkaq, mbrojtësit e të akuzuarve dhe të akuzuarit në ankesat e tyre përveç tjerash theksojnë se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë i gjendjes faktike bëjnë që edhe dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve të jenë të kundërligjshme.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.GJ. në ankesën e tij thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit të akuzuarve nuk ka bërë individualizimin e dënimit, por për të gjithë të akuzuarit i vlerëson në mënyrë mekanike rrethanat e njëjta rënduese dhe lehtësuese. Mbrojtësi i të akuzuarit B.Z.1. përveç tjerash në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë fare nuk i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese për të mbrojturin e tij se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin dhe se është i sëmurë nga kanceri. Po ashtu edhe në ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve SH.Z., A.K. dhe në ankesat e të akuzuarve SH.Z. dhe Q.B. theksohet se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marr parasysh si rrethana lehtësuese rrethanat familjar të tyre, se janë mbajtës të familjes, gjendjen ekonomike e as faktin se nuk kanë të kaluar kriminale dhe sinqeritetin e shprehur gjatë shqyrtimit gjyqësor. A.E., në ankesë thekson faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë, andaj, gjykata është dashur ti shqiptoj dënim më të ulët dhe më të favorshëm.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarve si rrethana rënduese mori: mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, se kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet që i kanë ndërmarrë, kanë qenë zbatues të ligjit dhe kanë qenë në dijeni për pasojat që mund të kenë këto veprime, ndërsa si rrethana lehtësuese këtyre të akuzuarve ju ka marrë: faktin se më parë nuk kanë qenë të dënuar, është hera e parë që ballafaqohen me drejtësinë, gjendjen e tyre ekonomike, sjelljen korrekte para gjykatës, moshën e tyre, se janë mbajtës të familjes dhe janë familjarë. Kurse të akuzuarve M.B. dhe A.E., gjykata e shkallës së parë si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit që nga shqyrtimi fillestar dhe pendimin e tyre për kryerjen e veprës penale.

Vlerësimin e këtyre të rrethanave për matjen e dënimit si të drejtë e aprovon edhe kjo Gjykatë, mirëpo duke pasur parasysh se Gjykata e Apelit e ndryshoi cilësimin juridik të veprave penale për të cilat u shpallën fajtor të akuzuarit: SH.D., S.V., N.R., I.A., I.GJ., A.E., B.Z.1., B.Z.2., Q.B., A.G., S.N., SH.G., L.G., SH.Z. dhe M.B. dhe veprimet e tyre i cilësoi si vepra penale në vazhdim ashtu që këta të akuzuar i shpalli fajtor për veprën penale në vazhdim dhe në bashkëkryerje-marrje ryshfeti nga neni 428 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 par. 1 nën par. 1.3, 1.4 dhe 1.5 të KPRK, kjo Gjykatë iu shqiptoi dënime si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimet e shqiptuara këtyre të akuzuarve i përgjigjen shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale për të cilën këta të akuzuar u shpallën fajtor dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve, si kryerës, dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 ( 34 i vjetri) të KPPK.

Gjykata e Apelit vlerëson se dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së pare të akuzuarit Ardian Reçaj, SH.Z., A.K. dhe N.Z., janë në përpjesëtim me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të verës së kryer penale për të cilën këta të akuzuar u shpallën fajtor dhe shkallës së përgjegjësisë penale të tyre, si kryerës, dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 ( 34 i vjetri) të KPPK. Për një dënim më të butë nuk janë plotësuar kushtet ligjore sepse rrethanave që u referohen ankesat nuk janë të natyrës së tillë që do të arsyetonin një dënim më të butë.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për dënime më të ashpër, si pretendon prokurori në ankesën e tij, sepse në ankesë nuk jepet asnjë arsye konkrete, asnjë rrethanë që në çfarëdo mënyre ka ndikues në ashpërsimin e dënimit, por vetëm theksohet në mënyrë të përgjithësuese se me dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së pare nuk do të arrihet qëllimi i dënimit. Dispozita e nenit 394 të KPRK ka përcaktuar kufijtë e shqyrtimit të ankesës dhe kur Gjykata e Apelit vepron sipas detyrës zyrtare. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar përkritazi me propozimin e Prokurorit për ashpërsimin e dënimit e shqyrton vetëm përkritazi me pretendimet ankimore. Për më tepër, në ankesë nuk precizohet se cili dënim të ashpërsohet, dënimi si tersi ( me gjobë dhe burgim) meqë të akuzuarve u janë shqiptuar dënime kumulativev, por vetëm propozon’’që të akuzuarve ti shqiptoj dënim më të rëndë’’.

Për të akuzuarit S.V., M.B. (të cilët nuk kanë paraqitur ankesa) dhe të akuzuarin A.E. (i cili aktgjykimin e ankimon vetëm për shkak të vendimit për dënimin), Gjykata e Apelit duke vepruar sipas detyrës zyrtare konform nenit 397 të KPRK me aplikimin e parimit Beneficium Cohesionis, ka vendosur sikurse ankesa e tillë të ishte paraqitur edhe nga këta të akuzuar.

Më ankesat e mbrojtësve të akuzuarve N.R., SH.D. dhe B.Z.2., aktgjykimi i shkallës së pare nuk ankimohet për shkak të vendimit për dënim, mirëpo Gjykata e Apelit duke vepruar konform nenit 396 të KPPK ( efekti shtesë i ankesës), ankesat e tyre i shqyrtoi edhe në këtë drejtim.

Nga çka u tha më lartë, në pajtim me dispozitën e nenit 403 par.1 nën par.1.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**PAKR 246/2018 datë 29.01.2019**

**Procesmbajtës,**

Përparim Zeka

**Anëtarët e kolegjit,**

Tonka Berishaj

**Kryetari i kolegjit,**

Have Haliti

Abdullah Ahmeti

---